

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Shërbim për ruajtjen e kushteve higjieno-sanitare dhe kontrollin e faktorëve të dëmshëm në ambientet e brendshme dhe të jashtme

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 9092100-9

Sherbime dezinfektimi dhe asgjësimi

Fondi limit: 3.948.217,67 (Tre million e nëntëqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e shtatëmbëdhjetë presje gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH.

Argumentimi: Perlllogaritja e vleres se fondit limit eshte bere referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021, të ndyshuar

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **SHRUKD SH.A** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Liçencë per kategorine II.8.B. “Shërbime ndërhyrëse higjiëno-shëndetësore”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave perkatëse ligjore dhe nën ligjore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomik-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; (lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesitë e veteqeverisjes vendore për vitin 2026), në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshillave Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Shenim: *Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, faturave tatimore të shitjes dhe të deklaruara në organet tatimore,, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Licencë për shërbime ndërhyrëse higjeno-shëndetësore me kod II.8.B.
- Licencë për shërbime ekspertize higjeno-shëndetësore II.8.A.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 germa a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL)”, i ndryshuar. Sipas këtij vendimi, nënkategoria II.8.B parashikon dhënien e licencës për ofrimin e shërbimeve ndërhyrëse higjeno-shëndetësore (deratizim, dezinfektim, dezinfektim), të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit publik. Për të siguruar që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik dhe ligjor, kërkohet paraqitja e kësaj

licence. nënkategoria II.8.A përcakton licencën për ofrimin e shërbimeve të ekspertizës higjieno-shëndetësore. Kjo licencë është e nevojshme për garantimin e profesionalizmit dhe aftësisë shkencore të subjektit që merr përsipër vlerësime dhe masa lidhur me higjienën dhe shëndetin publik. Kërkimi i kësaj licence lidhet ngushtë me sigurinë e kryerjes së procedurave në përputhje me standardet shëndetësore.

2.3.3 Kapaciteti njerëzor

Operatori ekonomik duhet të disponojë stafin e nevojshëm për realizimin e kontratës, konkretisht:

- Të ketë të punësuar **jo më pak se 8 (tetë) punonjës** gjithsej.
- Nga këta, **minimumi 6 (gjashtë) punonjës** duhet të jenë të angazhuar në shërbimet e dezinfektimit dhe të pajisur me **Certifikata Kualifikimi/Trajnimi në fushën DDD (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim)**.
- Të ketë të punësuar **1 (një) Përgjegjës Shërbimi / Drejtues Teknik**, i cili duhet të zotërojë diplomë universitare në një nga fushat: **Biologji, Kimi, Agronomi ose Shëndet Publik**.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, për periudhën e fundit të deklaruar, që konfirmon numrin e punonjësve të punësuar.*
- b) Listpagesat e punonjësve, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse, sipas formatit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, për periudhën e fundit të deklaruar.*
- c) Formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën përkatëse.*
- d) Certifikatat e kualifikimit/trajnitimit për punonjësit e angazhuar në shërbimet DDD.*
- e) Diplomën universitare të Përgjegjës të Shërbimit / Drejtuesit Teknik.*

Shenim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe në nenin 41, pika 4/ b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë.

Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Kjo është arsyeja që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij persona të kualifikuar. Kërkesa e AK që OE duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 8 (tetete) punonjës mes te cileve 6

punonjes sherbimi DDD dhe nje drejtues teknik është në funksion të zërave të shërbimeve që kërkohen të realizohen, ndarjes ne disa grupe njeheresh per realizimin e shërbimeve dhe vendodhjes se ku do të kryhen keto shërbime që përfshijnë zona të ndryshme gjeografike. Përgjegjësi i shërbimit nevojitet për organizimin, drejtimin, ndarjen dhe mbikëqyrjen e punëve, me qëllim që shërbimi objekt prokurimi të kryhet sipas specifikimeve teknike. Duke vlerësuar që shërbimi, objekt prokurimi ka një ndikim të drejtëpërdrejtë mjedis dhe ne shendetin e punonjesve vlerësohet që përgjegjësi i shërbimit/drejtuasi teknik të jete sipas percaktimit ne Ligjin nr 95/2015 si / Biolog/Kimist/Agronomi /Shëndet public, i cili do të kryejë mbikëqyrjen e realizimit të shërbimit, objekt prokurimi, konform kushteve dhe standarteve të kërkuara për mbrojtjen e mjedisit, si dhe në specifikimet teknike. Punonjësit e shërbimit janë të nevojshëm për të kryer të gjitha zërat e shërbimit, objekt prokurimi, si sherbimin dhe duhet te jene te trajnuar dhe certifikuar duke marre parasysh dhe ambjente sensitive ku do te duhet te operojne të përcaktuar në specifikimet teknike.

2.3.4 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të deklarojnë se posedojnë ose do të vënë në dispozicion të Autoritetit Kontraktor mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e shërbimit, të shoqëruara me skedat teknike për secilën pajisje, ku të pasqyrohen specifikimet teknike përkatëse..

Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht pajisjet si më poshtë:

- **Kurthe multifunkionale për brejtës**
- **Karta ngjitëse për ambiente të brendshme për kapjen e brejtësve**
- **Pompa për spërkatje të jashtme, jo më pak se 4 (katër) copë**
- **Pompa ULV për spërkatje të brendshme, jo më pak se 4 (katër) copë**

Shenim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: “Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri dhe lloji i makinerive dhe paisjeve është vendosur duke ju referuar zerave te sherbimit sipas specifikimeve teknike dhe sipas kohëzgjatjes së shërbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të provojë disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike, në pronësi ose të siguruar nëpërmjet marrëveshjeve përkatëse, të cilat janë të nevojshme për realizimin e kontratës.

Nr/R	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	<i>Automjete ATP per transport personeli dhe materiale per sherbime DDD</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
2	<i>Aparate mjegulluese me pompë me presion, të montuar në kamionçinë</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>

Mjetet me lart te përmendura duhet të jenë në pronësi ose me qira dhe ofertuesi duhet të paraqesë deklarinimin për disponimin e makinerive (sipas shtojcës 10) të shoqëruar me dokumentat e mëposhtëm:

- a) ***Aktin e pronësisë së mjetit përkatës:*** Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, taksa e mjetit dhe siguracioni i mjetit (i vlefshëm) si dhe certifikate transporti (akt - miratimi higjieno – sanitar) të leshuara nga autoritetet përkatëse (ISHSH) për subjektin dhe për automjetet për transport

Ose

- b) ***Kontratën e marrjes me qira të mjetit,*** shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale dhe të jetë specifike për objektin që prokurohet dhe afatin e realizimit të kësaj kontrate.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, taksa e mjetit dhe siguracioni i mjetit (i vlefshëm) si dhe certifikate transporti (akt - miratimi higjieno – sanitar) të leshuara nga autoritetet përkatëse (ISHSH) për subjektin dhe për automjetet për transport

Argumentimi: “Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri dhe lloji i makinerive dhe pajisjeve është vendosur duke ju referuar zerave të shërbimit sipas specifikimeve teknike dhe sipas kohëzgjatjes së shërbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative.

Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve/pajisjeve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në zerat e shërbimit. Nga ana e autoritetit kontaktor vendosja e këtij kriteri është në përpjestim më natyrën, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës.

1. Automjete ATP për transport personeli dhe materiale për shërbime DDD (3 copë)

Këto automjete janë të domosdoshme për transportin e stafit të specializuar dhe materialeve/pajisjeve të nevojshme për kryerjen e shërbimeve DDD në ambientet përkatëse. Posedimi i këtyre mjeteve siguron ndërhyrje të shpejtë dhe efikase, si dhe respektim të kushteve higjieno-sanitare gjatë transportit.

2. Aparat mjegullues me pompë me presion, i montuar në kamionçinë (1 copë)

Pajisja është thelbësore për kryerjen e trajtimeve dezinfektuese dhe dezinfektuese në hapësira të mëdha të jashtme. Montimi në kamionçinë rrit lëvizshmërinë dhe mbulimin efektiv të zonave, duke garantuar efikasitet në shpërndarjen e substancave kimike në sipërfaqe të gjera. Ky mjet është i lidhur drejtpërdrejt me kërkesat e kontratës për DDD.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

-Çertifikatën ISO 9001:2015 (ose Ekuivalent) mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë, e vlefshme dhe e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

-Çertifikatë ISO 14001:2015 (ose Ekuivalent) mbi sistemin e menaxhimit të mjedisit e vlefshme dhe e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

-Çertifikatën ISO 45001:2018 (ose Ekuivalent) lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e vlefshme dhe e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/DIN/EN/UNI/ISO mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të

akredituara në Republikën e Shqipërisë Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në nenin 44 “Kërkesat e Cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Nisur nga norma ndërkombëtare që përfaqëson ISO-ja 9001:2015 “Sistemi për Menaxhim të Cilësisë”, aplikohet për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar në fushën e shërbimeve DDD pavarësisht madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë. Vendosija e ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

Në objektin e kontratës janë parashikuar shërbime me kimikate/helme, të cilat kanë impakt në mjedis si dhe rrezikojnë në mënyre të vazhdueshme jetën dhe shëndetin e punonjësve që do të angazhohen për kryerjen e këtyre shërbimeve dhe personelit tone që punon në këto ambiente, kështu që rrjedhimisht kërkesat për dy certifikatat ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018 janë kërkesa të nevojshme.

Standarti ISO 14001:2015 “Sistemi manaxhimit të mjedisit” është e lidhur me mjedisin dhe ndihmon në përmirësimin e imazhit të shoqërisë në lidhje me klientet e saj, komunitetin dhe autoritetet kontraktore. Në të njëjtën kohë manaxhimi i duhur i çështjeve lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e ndotjeve ndihmojnë në rritjen e konkurrencës së shoqërisë shoqëruar me uljen e shpenzimeve. Angazhimi për mbrojtjen e mjedisit është një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi kurse metoda më e thjeshtë dhe më e efikasitet për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistemi manaxhimi për mjedisin në konformitet me parashikimet e standartit ndërkombëtar ISO14001. Perfitimet kryesore për këtë sistem manaxhimi janë: paraqitja e angazhimit për mbrojtjen e mjedisit nga klienti, investitorët potencialë, komuniteti, autoritetet; zvogelimin e shpenzimeve nëpërmjet përmirësimit të administrimit mbeturinave dhe uljen e konsumit të burimeve; parandalimin e incidenteve të mundshme që mund të çojnë në pagesën për dëmshpërblim dhe dëm; përmirësimin e marrëdhënieve me autoritetet; mundësi për hyrje në tregje të reja.

Standarti ISO 45001 përfaqëson një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem manaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të kompanisë me udhëzime për përdorimin e tij, për të mundësuar një organizatë që të përmirësojë në mënyrë proaktive performancën e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të saj. Kjo ISO ka për qëllim të jetë e zbatueshme për çdo organizatë përfshirë dhe subjektet tregtare pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra e saj.

Në këtë kuptim, AK në vendosjen e kriterëve të mësipërme kërkon garanci në lidhje me përmbushjen me sukses dhe në afat të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë, të cilët duhet të dëshmojnë performancën e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të tyre.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë një ambient, në pronësi ose me qira, të dedikuar për magazinimin e lëndëve biocide. Ky ambient duhet të jetë i pajisur me **Akt-Miratim Higjeno-Sanitar**, të lëshuar nga **Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH)**, në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht me ligjin nr. 7643, datë 02.12.1992 “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në nenin 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin shëndetësor publik” të ndryshuar. Ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar përdorimin e kontrolluar të substancave, mbrojtjen e shëndetit publik dhe të punonjësve, si dhe realizimin me sukses të kontratës në përputhje me standartet teknike dhe ligjore.

2.4 Kërkesë për dokumentacion teknik të produkteve

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë me pajisjet e tij shërbimin e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit në preparate të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këto preparate duhet të jenë produkte biocide të autorizuar për tu vendosur në treg në Republikën e Shqipërisë. Produktet Biocid autorizohen në vendin tonë sipas Ligjit nr.95/2015 „Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”.

- **Shërbimi i dezinfektimit:**

do të kryhet me produkte dezinfektante për ambientet e brendshme.

Shërbimi i Dezinfektimit, me lëndët aktive që do të përdoren për shërbimin e dezinfektimit të jenë në listën e shtojcës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe të jenë të vlerësuara për efikasitetin e tyre nga institucionet kompetente.

- **Shërbimi i dezinfektimit:**

Do të kryhet me produkte:

- 1-Produkt për fazën adulte i klases piretoride për ambientet e jashtme dhe të brendshme
- 2-Produkt për fazën adulte i klases jo piretoride për ambientet të brendshme
- 3-Produkt në trajtë xheli për tu aplikuar për luftimin e furretareve për ambientet e brendshme
- 4-Produkt në trajtë xheli për përdorim për luftimin e miligonave për ambientet e brendshme

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Fletët e të Dhënave të Sigurisë (MSDS/SDS)**, të përditësuara në përputhje me **Rregulloren (BE) 2020/878**, për të gjitha produktet që do të përdoren

gjatë zbatimit të kontratës, si biocide ashtu edhe jo biocide. Dokumentacioni duhet të paraqitet në gjuhën shqipe.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- **Etiketat për të gjitha produktet biocide që do të përdoren;**
- **Katalogët dhe/ose skedat teknike për të gjitha produktet jo biocide.**

I gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet në gjuhën shqipe.

***Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të një vetëdeklarimi, të nënshkruar dhe vulosur nga administratori ose personi i autorizuar.**

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose në rast se kërkohet për sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Ne hartimin e specifikimeve teknike AK ka marrë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin e elementeve me të rëndësishëm përberës që garantojnë cilësinë e kërkuar të shërbimit në përputhje me nenin 36 të LPP, dhe kërkesën për shërbime të pranueshme për funksionet e kërkuara. Nuk është përcaktuar asnjë lëndë aktive. Specifikimet teknike të shërbimeve objekt prokurimi janë hartuar duke u bazuar në nevojat reale të përdorimit dhe në përputhje me, nenin 4, pikë 38 si dhe nenin 36, pikë 2 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020. Preparatet me të cilat do të kryhen shërbime të kërkuara garantojnë marrjen e masave efektive për parandalimin e infeksioneve nga demtuesit në shëndetin publik, sipas detyrimeve të përcaktuara në legjislativonin në fuqi. Sipas përcaktimeve në etiketën e preparateve me përmbajtje piretoride, ato mund të shkaktojnë parestezi. Këto produkte lënë mbetje në mjedis, dhe efekti negativ i tyre tek njerëzit mund të shfaqet edhe disa ditë pas trajtimit me këto preparate. Për të shmangur problemet shëndetësore në këto mjedise sensitive, është i domosdoshëm përdorimi i preparateve biocide natyrore jo piretroide. Shfaqja e insekteve zvarritese, kryesisht buburrecat e zinjë, ndikuar nga lageshtia ajrore, është një nga problematikat me të shfaqura në ambientet tona. Ky problem është i njëjti çdo vit. Luftimi i tyre në ambiente specifike me insekticide të klases piretroide të tretshme në ujë dhe me spërkatje ka qenë i pamundur për shkak të rezistencës që kanë shfaqur. Për këtë arsye është i domosdoshëm përdorimi i një insekticidi i një klase tjetër, të klases jo piretroide që qëndron me teper në mjedis, dhe duke qenë në klasën jo piretroide nuk lënë mbetje në mjedisin që do aplikohet pas pastrimit manual. Shkencërisht, produktet e klases jo piretoride nuk veprojnë në sistemin nervor por janë insekticide fizike. Nuk shkaktojnë rezistencë sepse verpojnë fizikisht dhe jo nëpërmjet receptoreve nervore. Janë miqësore me mjedisin sepse ndryshe nga produktet e klases piretroide janë substanca natyrore, jo sintetike. Përcaktimi i gjendjes fizike dhe natyrës së produktit biocid të kërkuar, me lëndë pjesë e VKM Nr.933 dt 25.22.2020, është e lidhur me kërkesat funksionale dhe natyrën e shërbimit që do kryhet me këto produkt.

Produktet Biocid autorizohen në vendin tonë sipas Ligjit nr.95/2015 „Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik. Çdo produkt duhet të pajiset me autorizim para vendosjes në treg dhe rregistrohen në regjistrim kombëtar të produkteve biocide. Bërja e disponueshme në treg e produkteve biocide pa autorizim përben kundravajtje administrative, sipas legjislativonit në fuqi.

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **deklaratë**, të nënshkruar dhe vulosur nga administratori ose personi i autorizuar, me anë të së cilës konfirmon se disponon ose do të vërë në dispozicion **pajisjet dhe instrumentet minimale të nevojshme** për realizimin e kontratës, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, duke vlerësuar proceset e këtij shërbimi, disponimi i këtyre pajisjeve lidhet ngushtësisht me realizimin e shërbimeve objekt prokurimi. Llojet e pajisjeve të nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi janë përcaktuar nga vetë autoriteti kontraktor.

2.4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **deklaratë**, të nënshkruar dhe vulosur nga administratori ose personi i autorizuar, me anë të së cilës merr përsipër që shërbimet do të kryhen nga punonjës të pajisur me **uniformë pune**, si dhe me **materiale dhe pajisje mbrojtëse personale**, në përputhje me kërkesat e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar në ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurimin e shëndetit dhe sigurisë në punë", si dhe akteve nënligjore përkatëse ky kriter kërkohet pasi punëdhënësi është i detyruar të marrë masa për mbrojtjen teknike dhe organizative të punonjësve, në përputhje me natyrën e riskut të veprimtarisë. Në rastin e shërbimeve DDD, ku ekspozimi ndaj substancave kimike dhe faktorëve biologjikë është i lartë, pajisja me uniformë dhe pajisje mbrojtëse personale (PPE) është jo vetëm domosdoshmëri profesionale, por edhe kërkesë ligjore për parandalimin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale. Kjo deklaratë siguron përputhshmërinë me ligjin dhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve.

2.4.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Autorizimi prodhuesi** ose nga distributori i autorizuar prej tij, që vërteton se është i autorizuar për furnizimin dhe përdorimin e lëndëve biocide që do të përdoren në realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Në rast se autorizimi lëshohet nga distributori i autorizuar, duhet të paraqitet edhe dokumentacioni që vërteton **marrëdhënien e autorizimit midis distributorit dhe prodhuesit**.

Letra e autorizimit duhet të përmbajë minimalisht:

- Emrin e plotë të prodhuesit dhe/ose distributorit;
- Të dhëna identifikuese të plota të prodhuesit, përfshirë: **adresë, numër telefoni, e-mail dhe website zyrtar**;
- Specifikimin e produkteve për të cilat jepet autorizimi;
- Kohëzgjatjen e vlefshmërisë së autorizimit;
- Të dhëna të plota të operatorit ekonomik të autorizuar.

Ky dokument kërkohet për qëllime verifikimi nga Autoriteti Kontraktor dhe duhet të jetë i vlefshëm për periudhën e zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, si dhe në zbatim të Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 25.11.2020 “Përcaktimi i rregullave për vlerësimin e produkteve biocide dhe i procedurës për dhënien e autorizimit për vendosjen e tyre në treg”, ky kriter është thelbësor për sigurimin e përdorimit korrekt, të sigurt dhe në përputhje me ligjin të produkteve si dhe garanton që operatori ekonomik ka njohuri teknike për produktin, duke shmangur rreziqet për shëndetin publik dhe gjithashtu ndihmon në gjurmueshmërinë dhe ruajtjen e standarteve profesionale në treg.

2.4.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ose dokumentin e regjistrimit për produktet biocide, në një prej vendeve e përcaktuara në Ligjin 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 germa a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që produktet biocide janë të certifikuar për cilësi dhe siguri, të regjistruara në vende me standarde të njohura ndërkombëtare, dhe përputhen me Ligjin nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”. Ky kriter është i domosdoshëm për të siguruar mbrojtjen e shëndetit publik, kontrollin e cilësisë dhe shmangien e përdorimit të produkteve të pasigurta ose të jashtëligjshme.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIME TEKNIKE

Shërbim për ruajtjen e kushteve higjiëno-sanitare dhe kontrollin e faktorëve të dëmshëm në ambientet e brendshme dhe të jashtme

1. Qëllimi i Shërbimit

Qëllimi i kryerjes së shërbimit të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit për shoqërinë rajonale ujësjellës-kanalizimeve durrës sh.a është garantimi i kushteve higjiëno-sanitare dhe mbrojtja e shëndetit publik në të gjitha ambientet dhe objektet që administrohen nga shoqëria, duke siguruar funksionimin normal dhe të sigurt të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Ky shërbim synon parandalimin dhe eliminimin e mikroorganizmave patogjenë, insekteve dhe brejtësve që mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e ujit, sigurinë sanitare të ambienteve të punës dhe infrastrukturës teknike të shoqërisë. Nëpërmjet dezinfektimit realizohet reduktimi i ngarkesës mikrobiale në ambiente, depo, rezervuarë, zyra, mjete transporti dhe hapësira të tjera funksionale. Dezinfektimi synon kontrollin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse në ambientet administrative dhe teknike, ndërsa deratizimi ka për qëllim kontrollin dhe eliminimin e brejtësve që mund të shkaktojnë ndotje, dëmtime infrastrukturore apo përhapje sëmundjesh.

Shërbimi do të kryhet duke përdorur preparate dhe metoda profesionale të certifikuara, në përputhje me standardet higjiëno-sanitare, rregullat e sigurisë në punë dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit.

2. Objekti i Shërbimit

Shërbimi përfshin:

- Ambiente të brendshme;
- Ambiente të jashtme;
- Zyra;
- Korridore;
- Tualete;
- Magazine;
- Hapësira teknike;
- Siperfaqe të jashtëm.

3. Specifikimet Teknike të Shërbimit

3.1 Dezinfektimi

Përshkrimi

Dezinfektimi konsiston në eliminimin ose reduktimin e mikroorganizmave patogjenë në sipërfaqe dhe ambiente.

Kërkesat Teknike

Operatori ekonomik duhet:

- Të përdorë preparate të certifikuara dhe të aprovuara nga autoritetet kompetente;
- Të përdorë pajisje profesionale për spërkatje, nebulizim ose atomizim;
- Të kryejë trajtimin pa dëmtuar mobiliet, pajisjet apo ambientin;
- Të respektojë normat e sigurisë dhe higjienës gjatë aplikimit.

Produktet

Produktet dezinfektuese duhet:

- Të kenë fletë sigurie (MSDS/SDS);
- Të jenë të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi;
- Të mos jenë toksike për njerëzit pas kohës së rekomanduar të ventilimit.

3.2 Dezinsektimi

Përshkrimi

Dezinsektimi konsiston në luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse si:

- Mushkonja;
- Miza;
- Burreca;
- Milingona;
- Pleshta;
- Rriqra etj.

Kërkesat Teknike

Operatori ekonomik duhet:

- Të përdorë insekticide profesionale me veprim të shpejtë dhe rezidual;
- Të aplikojë metoda të sigurta për njerëzit dhe kafshët;
- Të kryejë monitorim periodik të infestimit;
- Të përdorë pajisje ULV, pompa presioni ose metoda të tjera profesionale.

3.3 Deratizimi

Përshkrimi

Deratizimi konsiston në kontrollin dhe eliminimin e:

- Minjve;
- Brejtësve të tjerë.

Kërkesat Teknike

Operatori ekonomik duhet:

- Të përdorë stacione karremi të sigurta dhe të mbyllura;
- Të vendosë karremat në pika strategjike;
- Të evidentojë dhe monitorojë aktivitetin e brejtësve;
- Të përdorë rodenticide të autorizuara.

Siguria

- **Kurthet** duhet të jenë të mbrojtur nga aksesit i personave të paautorizuar;
- Duhet të vendosen tabela paralajmëruese kur është e nevojshme.

4. Operatori Ekonomik

Operatori ekonomik duhet të:

- Jetë i licencuar për shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore me kod II.8.B dhe për shërbime ekspertize higjieno-shëndetësore II.8.A ;
- Ketë staf të trajnuar dhe të pajisur me mjete mbrojtëse personale;
- Disponojë pajisje profesionale;
- Paraqesë dokumentacionin teknik të preparateve të përdorura Etiketat dhe Kataloge dhe/ose skedat teknike për të gjitha produktet biocide që do të përdoren;
- Respektojë standardet e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

5. Raportimi dhe Dokumentacioni

- Pas kryerjes së shërbimit duhet të hartohet **raport teknik**, ku përshkruhen:
 - Data dhe zona e trajtimit
 - Produktet e përdorura dhe sasia
 - Vëzhgime dhe rekomandime teknike

6. Kërkesa për Sigurinë dhe Mjedisin

- Të shmangët ndotja e mjedisit;

- Të përdoren preparate me ndikim minimal ekologjik;
- Mbetjet të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi;
- Personeli të përdorë pajisje mbrojtëse personale gjatë gjithë procesit.

7. Afatet e Kryerjes së Shërbimit

- Shërbimi duhet të realizohet brenda 1 muaji duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.

Shërbimet që kërkohen që kërkohen dhe sipërfaqet:

Nr	Përshkrimi	Sip.Jashtme Toke m2 Total	Sip. Objekt m2 Total	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1	Shërbim për ruajtjen e kushteve higjieno-sanitare dhe kontrollin e faktorëve të dëmshëm në ambientet e brendshme dhe të jashtme	469.888	33.459	Ne te gjithe territorin qe mbulon SHRUKD sh.a	1 muaj

Vendi i ekzekutimit: Ambjentet e brendshme dhe te jashtme te sip dhe objekteve qe perfshin Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres sha.

Nr	Bashkia	Institucioni	Njesia Adminis	Sip.Jashteme Toke m2	Sip. Objekte m2
1	Durres	Zyra administrate, St. pompa, depo uji, puset, impiante perpunimi	Ne te gjithe territorin e bashkise Durres	407155	20810
2	Kruje	Zyra administrate, St. pompa, depo uji, puset,	Ne te gjithe territorin e bashkise Kruje	7125	2866
3	Kavaje	Zyra administrate, St. pompa, depo uji, puset, impiante perpunimi	Ne te gjithe territorin e bashkise Kavaje	27802	6290
4	Rrogozhine	Zyra administrate, St. pompa, depo uji, puset,	Ne te gjithe territorin e bashkise Rrogozhine	27806	3943
TOTALI				469.888	<u>33.459</u>

Nr	Përshkrimi	Sipërfaqja ne m2	Nr i trajtimeve deri ne 31 Dhjetor 2026	
1	Shërbim për Dezinsektim, Deratizim për sipërfaqet e jashtme	469888	1	
2	Shërbimi për Dezinsektim, Dezinsektim, Deratizim per sipërfaqet e brendshme	<u>33459</u>	1	
3	Shërbim për largimin e gjarpërinjve	469888	1	

Afatet e ekzekutimit: Afati I kryerjes së shërbimit do të jetë 1 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.